



## KËRKESË PËR OFERTIM

### REQUEST FOR OFFER

<b>Titulli i projektit / Project Title:</b>	<b>WB-Edu4Migration</b> - Mitigating Migration Challenges in the Western Balkans: Bridging the Skills Gap for Social Care Providers via Curricula Enhancement and Micro Credential Development
<b>Titulli i aktivitetit / Activity Title:</b>	Blerje e paisjeve per qellim te implementimit te projektit
<b>Numri i referencës së projektit / Project Reference Number</b>	101179745
<b>Agjencia donatore / Sponsoring Agency:</b>	European Education and Culture Executive Agency (EACEA)
<b>Periudha e implementimit të projektit/ Project Implementation Period:</b>	36 months

### 1. Informata rreth Kolegjit AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë i cili është themeluar menjëherë pas luftës në Kosovë, pas krijimit të rrethanave të reja ekonomike-sociale e kulturore, kur u krijuan kushte dhe rrethana për jetë normale të qytetarëve të Kosovës. Në fillimet e tij institucioni ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv duke u zgjeruar vazhdimisht me programe studimore në fushat e tjera dhe duke u shndërruar kështu në institucion model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Sot, Kolegji AAB ofron programe studimi të nivelin baçelor dhe master në 14 fakultete të ndryshme. Njëkohësisht, Kolegji AAB është implementues i shumë projekteve ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

### 2. Informata të përgjithshme rreth projektit

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të projektit ‘WB-Edu4Migration - Mitigating Migration Challenges in the Western Balkans: Bridging the Skills Gap for Social Care Providers via Curricula Enhancement and Micro Credential Development’ i cili ka për qëllim të forcimin e kompetencave të studentëve dhe punonjësve socialë në Kosovë dhe Shqipëri për të mbështetur më mirë popullatat migrante. Kjo do të arrihet përmes reformave edukative, zhvillimit të kurseve digjitale dhe iniciativave për ndihmën e vazhdueshme. Projekti synon të fuqizojë punonjësit socialë me njohuri dhe burime për të mbështetur migrantët dhe për të promovuar praktikën inkluzive në komunitetet e tyre. Projekti parasheh një seri aktivitetesh të strukturuar me qëllim përmirësimin e edukimit dhe praktikës në punën sociale në Kosovë dhe Shqipëri, veçanërisht në lidhje me çështjet e migracionit. Aktivitetet kryesore përfshijnë realizimin e vlerësimeve për të identifikuar sfidat që lidhen me migracionin, si dhe zhvillimin e udhëzimeve për kurset e mikro-credentialeve online.





Projekti gjithashtu do të përfshijë rishikimin dhe përmirësimin e kurikulave ekzistuese në kujdesin social, trajnimin e stafit akademik përmes programeve "Trajnimi i Trajnerëve", dhe pilotimin e kurikulave të rishikuara në universitetet partnere.

### 3. Objekti i ofertës

Të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë që të dorëzojnë ofertat e tyre për blerjen e pajisjeve të listuara në vijim:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve/	Specifikat teknike të pajisjeve	Sasia
1	Laptop	<ul style="list-style-type: none"><li>I7, 16GB RAM, 512GB SSD, 15.6", NVIDIA GTX 1650 / RTX 3050 / AMD Radeon RX 6500M.</li></ul>	1
2	Laptop	<ul style="list-style-type: none"><li>I5, 8GB RAM, 512GB SSD, 15.6", NVIDIA GTX 1650 / RTX 3050 / AMD Radeon RX 6500M.</li></ul>	1
3	Kamerë	<ul style="list-style-type: none"><li>4K Ultra HD video at 30 fps,</li><li>HD 1080p at either 30 or 60 fps, and</li><li>HD 720p at 30</li></ul>	1
4	Degjuese	<ul style="list-style-type: none"><li>Wireless ANC headset, great for calls &amp; recording.</li><li>Crystal-clear mic, AI-enhanced noise cancellation.</li><li>Bluetooth &amp; USB dongle, multipoint connection.</li><li>Up to 30h battery, lightweight &amp; comfortable.</li><li>Includes case, USB-C cable, 3.5mm jack.</li></ul>	1
5	Mikrofon	<ul style="list-style-type: none"><li>USB condenser mic, plug-and-play.</li><li>20Hz - 20kHz, clear sound, zero-latency monitoring.</li><li>Built-in gain control, headphone jack, pop filter.</li><li>USB-powered, works with PC, Mac, tablets.</li><li>Includes stand, 6m cable, pouch.</li></ul>	1
6	Green Screen With Stand	<ul style="list-style-type: none"><li>Basic</li></ul>	1
7	Personal Computer	<ul style="list-style-type: none"><li>I7, RAM 16 GB, 256 GB SSD</li></ul>	1
8	Monitor	<ul style="list-style-type: none"><li>24"</li></ul>	2

### 4. Kushtet dhe kriteret për aplikim

Të gjitha bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ofertën financiare (bazuar në specifikat, çmimin e ofruar për njësi dhe kohën e liferimit).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Certifikatën e TVSH-së





# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale Prishtinë-  
Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në formë elektronike në email-in [dardan.krekaj@universitetiaab.com](mailto:dardan.krekaj@universitetiaab.com) dhe [projects@universitetiaab.com](mailto:projects@universitetiaab.com) me subject "Ofertë për "Edu4Migration". Çdo formë tjetër e dorëzimit të ofertave do të konsiderohet e papranueshme.

**Afati për dorëzimin e ofertave është më 13.03.2024, në ora 16.00.**

Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në bazë të kritereve si në vazhdim: çmimit ekonomikisht më të favorshëm (40 pikë), përmbushjes së specifikave teknike (40 pikë), dhe kohës së liferimit (20 pikë).



Co-funded by  
the European Union